



## RAPORTI VJETOR MBI SITUATËN ARSIMORE TË TË KTHYERVE TË DETYRUAR SI DHE ROMËVE, ASHKALIVE, DHE EGJIPTIANËVE

2015

### 1. Hyrje

#### 1.1. Konteksti

Arsimi është i përfshirë në *Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut* jo vetëm si e drejtë, por edhe si një mjet për zhvillim individual dhe për të kuptuarit mes grupeve të njerëzve të cilët kanë prejardhje dhe/ose orientime të ndryshme, ashtu si edhe për promovimin e respektimit të të drejtave të njeriut në përgjithësi.<sup>1</sup> Për më tepër, arsimi është kusht i nevojshëm për një shoqëri funksionale dhe përparimtare, me rolet e tij për këtë qëllim, duke përfshirë përgatitjen për punësim të qëndrueshëm dhe për qytetari aktive në një shoqëri demokratike, si dhe për zhvillimin dhe ruajtjen e një baze të gjerë dhe të avancuar të njohurisë.<sup>2</sup> Si rezultat i rëndësisë së arsimit si për individë po ashtu edhe për shoqëri, shtetet mbajnë përgjegjësi të madhe për sigurimin e qasjes në arsim cilësor për qytetarët e tyre; për të parafrazuar sociologun Eugenio Tironi, çfarë lloji i arsimit nevojitet është në fund të fundit pyetje se çfarë shoqërie dëshirohet.<sup>3</sup>

Në rrethana të pas konfliktit si ato në Kosovë\* sot, arsimi gjithashtu ka një rëndësi të veçantë për kontributin e tij në stabilizimin dhe normalizimin e marrëdhënieve shoqërore. Për më tepër, në nivelin individual, arsimi është një përbërës kyç në integrimin e përgjithshëm të personave që qëndrojnë në margjinat e shoqërisë, duke përfshirë (por, jo vetëm) personat e kthyer me detyrim në Kosovë nga shtetet tjera si dhe romët, ashkalitë dhe egjiptianët.<sup>4</sup>

Njohja e rolit qendror dhe të shumëfishtë të arsimit në integrimin e të kthyerve me detyrim dhe romëve, ashkalive dhe egjiptianëve në Kosovë është e dukshme jo vetëm në gamën e gjerë të dokumenteve të politikave të hartuara nga institucionet kyçe në Kosovë, duke përfshirë Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, Ministrinë për Integrim Evropian, Ministrinë për Arsim, Shkencë dhe Teknologji (MASHT) dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme, por edhe në deklaratat e përfaqësuesve të këtyre institucioneve në konferencën "Arsimimi i të kthyerve dhe komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë: Sfidat dhe zgjidhjet." Në këtë konferencë, Ministri për Arsim, Shkencë dhe Teknologji Ramë Buja foli për rëndësinë e arsimit gjithëpërfshirës për grupet të cilat në të kaluarën nuk kanë qenë tërësisht të përfshira, përderisa Ministri i Punëve të Brendshme Bajram Rexhepi adresoi barrierat gjuhësore me të cilat shpesh ballafaqohen të kthyerit e detyruar dhe romët, ashkalitë dhe egjiptianët.<sup>5</sup> Zëvendësmministri për Komunitete dhe Kthim Husnija Beshković iu referua arsimit si një e drejtë themelore së bashku me kujdesin mjekësor, banimin dhe qasjen në tregun e punës, përderisa Zëvendësmministri për Integrim Evropian Gëzim Kasapollli përmendi problemin e braktisjes së shkollës.<sup>6</sup>

\* Ky përcaktim është pa paragjykuar pozicionet rreth statusit, dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të KS të OKB-së dhe opinionin e GJND-së mbi Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

Konferenca, e cila u mbajt në prill 2014, ishte pjesë përbërëse e Programit të Përbashkët të BE/KiE "Mbështetja e Qasjes në Arsim dhe Mirëkuptim Ndërkulturor (ACCESS): Mbështetja nga BE/Këshilli i Evropës në fushën e arsimit për të kthyerit e detyruar dhe për komunitetet romë, ashkali dhe egjiptianë në Kosovë."<sup>7</sup> Ky aktivitet siguroi edhe shtysën e menjëhershme për themelimin e një grupi për të kanalizuar përpjekjet e përbashkëta të aktorëve kyçë brenda dhe jashtë Qeverisë së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me të kthyerit e detyruar dhe romët, ashkalitë dhe egjiptianët. I themeluar në kuadër të kornizës së punës së ACCESS-it në korrik të vitit 2014, "Grupi i Reflektimit për Arsimimin e të Kthyerve të Detyruar dhe Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve" ka bashkuar zbatuesit dhe politikëbërësit lokalë për të diskutuar dhe përparuar politikat për të kthyerit dhe strategjitë përkatëse që kanë të bëjnë me integrimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë në Kosovë.

Funksioni kryesor i Grupit të Reflektimit ishte që të jep rekomandime mbi veprimet, informacione dhe hulumtime të nevojshme për zbatimin më efektiv të politikave për të kthyerit si dhe strategjitë përkatëse që kanë të bëjnë me integrimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë. Puna e këtij Grupi mbështeti dhe pasuroi punën e organeve institucionale dhe ndër-institucionale të cilat merren me çështjet që kanë të bëjnë me arsimimin e të kthyerve dhe romëve, ashkalive dhe egjiptianëve, ashtu që Grupi i Reflektimit plotësoi dhe nuk zëvendësoi (as nuk kërkoi të zëvendësojë) mekanizmat tjerë ekzistues. Njëkohësisht, pozita e grupit jashtë qeverisë i dha atij fleksibilitet në raport me agjendën e tij dhe shfrytëzimin e burimeve shtesë të cilat janë në dispozicion përmes ACCESS-it, i cili siguroi ekspertizën dhe mbështetjen logjistike të nevojshme për të lehtësuar punën e Grupit të Reflektimit.

Anëtarësia e Grupit të Reflektimit kishte për qëllim që të sigurojë shkëmbim të hapur të përvojave, informatave dhe pikëpamjeve në arsimin e të kthyerve të detyruar dhe të romëve, ashkalive dhe egjiptianëve nga një spektër i gjerë i palëve me interes në akademi, shoqëri civile, institucione të Kosovës dhe organizata ndërkombëtare. Për më tepër, nga personat që nuk ishin anëtarë është kërkuar që të jenë pjesëmarrës në disa takime të Grupit me qëllim të shkëmbimit të informacioneve, materialeve ose njohurive relevante. Grupi i Reflektimit u takua çdo tre muaj, duke i ofruar udhëzime ACCESS-it, si dhe duke vepruar si bord këshillues për Qeverinë e Kosovës lidhur me politikat dhe aktivitetet për arsimin e të kthyerve dhe romëve, ashkalive dhe egjiptianëve.

### *1.2. Ky raport*

Përveçse për të ndarë me lexuesit përbrenda dhe jashtë Kosovës njohurinë e gjeneruar nga Grupit i Reflektimit për arsimin e të kthyerve të detyruar dhe romëve, ashkalive dhe egjiptianëve në vitin 2015, ky raport ka për qëllim që t'i asistojë Qeverisë së Kosovës në finalizimin e masave të ndërlidhura me arsimin të dokumentit të politikës që do ta zëvendësojë *Strategjinë për Integrimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë në Republikën e Kosovës dhe Planin e ndërlidhur të Veprimit*, të cilat skadojnë në vitin 2015.<sup>8</sup>

Pa e anashkaluar rëndësinë e vëmendjes së vazhdueshme për situatën arsimore të të kthyerve, ky raport reflekton theksin e punës së Grupit të Reflektimit në vitin 2015 për sa i përket romëve, ashkalive dhe egjiptianëve, me synim të kontributit në të siguruarit që përvoja e zbatimit të *Strategjisë dhe Planit të Veprimit* aktual të merret parasysh gjatë përpilimit të dokumentit të politikave të reja. Temat e takimeve të Grupit të Reflektimit në vitin 2015 kanë qenë: statusi i

zbatimit të *Strategjisë*; korniza e raportimit vjetor për *Strategjinë*; dhe ndërtimi i strategjisë holistike për arsimin e romëve, ashkalive dhe egjiptianëve.

Seksioni i dytë i raportit fillon me një pasqyrë të përgjithshme të *Strategjisë* dhe *Planit të Veprimit* për romët, ashkalitë dhe egjiptianët në kontekstin rajonal, e më pastaj ofron një shikim më të detajuar në trajtimin e arsimit në këto dy dokumente, si dhe në *Kornizën e Prioriteteve 2014-2015*, të adoptuar për qëllim të përsheptimit të zbatimit të *Strategjisë* në dy vitet e saj të fundit. Bazuar në gjetjet nga Anketa Grupore me Shumë Tregues (MICS) 2013-2014, Seksioni 3 ekzaminon zbrazëtitë në mes romëve, ashkalive dhe egjiptianëve në njërën anë dhe popullatën e përgjithshme në anën tjetër në lidhje me pjesëmarrjen në arsim afër përfundimit të periudhës së mbuluar nga *Strategjia* aktuale, duke ofruar një inventar të faktorëve që kontribuojnë në krijimin e këtyre zbrazësive. Seksioni 4 ofron një ekzaminim kritik të praktikave të raportimit në lidhje me *Strategjinë* aktuale si bazë për përmirësimin në raportimin e zbatimit të dokumentit të politikave të reja. Pjesa e pestë dhe e fundit e raportit ofron një rishikim të shkurtër të çështjeve kyçe në seksionet e mëparshme dhe ofron një sërë rekomandimesh që kanë të bëjnë me këto pika.

## **2. Politikat me synim të përqendruar në arsimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë në Kosovë**

### *2.1. Korniza e politikave për romët, ashkalitë dhe egjiptianët*

11 sektorët që strukturojnë *Strategjinë për Integrimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë në Republikën e Kosovës* përbëjnë një numër më të madh se atë që është prezent në strategjitë e shumicës së shteteve fqinje të Kosovës dhe shteteve anëtare të BE-së që janë pjesëmarrëse në Dekadën e Përfshirjes së Romëve.<sup>9</sup> Nga këto 13 shtete, vetëm dy (Bosnja dhe Hercegovina dhe Serbia) ndajnë strategjitë e tyre në më shumë se 11 sektorë.<sup>10</sup> Mali i Zi ka adoptuar një strategji që përmban 10 sektorë,<sup>11</sup> ndërsa strategjitë përkatëse të shteteve të tjera janë të organizuara rreth 5-7 sektorëve.<sup>12</sup>

Për sa i përket mbulimit të strategjisë për romë, ashkali dhe/ose egjiptianë që është adoptuar nga shtetet fqinje të Kosovës dhe shtetet e BE-së që janë pjesëmarrëse në Dekadë, të gjitha kanë të përbashkëta me *Strategjinë* e Kosovës përfshirjen (në seksione të ndara të dokumenteve përkatëse) e katër “fushave me prioritet” të Dekadës: arsimin, punësimin, shëndetin dhe banimin.<sup>13</sup> Dhjetë nga 13 strategjitë gjithashtu ia përkushtojnë një seksion ruajtjes dhe promovimit të kulturës romë, ashkali dhe/ose egjiptiane, ndërsa tetë përmbajnë një seksion për kundër-diskriminimin. Seksionet për regjistrimin dhe dokumentet, çështjet gjinore si dhe përfshirjen politike dhe përfaqësimin, secila paraqitet në pesë strategji. Më e pazakonshme është përfshirja e seksioneve të përqendruara në rolin policor (e bërë në Shqipëri dhe Republikën Çeke) si dhe kthimin dhe ri-integrimin (vetëm në Serbi).

Dallime më të mëdha në mes Kosovës, në njërën anë, dhe shteteve fqinje të saj dhe shteteve anëtare të BE-së që janë pjesëmarrëse në Dekadë, në anën tjetër, janë të dukshme në planet e veprimit për romë, ashkali dhe/ose egjiptianë të përpiluara në të gjitha 13 shtetet dhe të adoptuara në të gjithat përpos Rumanisë.<sup>14</sup> Shteti i vetëm me plane të veprimit për një numër më të madh të sektorëve se sa nëntë të Kosovës, është Serbia (me 13). Përderisa plani i veprimit të Kroacisë

gjithashtu mbulon nëntë sektorë, planet e veprimit të shteteve të tjera janë të ndara në tetë sektorë ose më pak, me shumicën të organizuar rreth 4-6 tema.

Siç është rasti me strategjitë për romë, ashkali dhe/ose egjiptianë, të gjitha planet e veprimit përfshijnë seksione të ndara që i përkushtohen arsimit, punësimit, shëndetit dhe banimit. Nga sektorët e tjerë të përfshirë në *Planin e Veprimit të Republikës së Kosovës për Integrimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë*, një që është më e përbashkëta në planet e veprimit të shteteve fqinje të Kosovës dhe të shteteve anëtare të BE-së që janë pjesëmarrëse në Dekadë është kultura, e cila shfaqet në planet e veprimit të gjashtë shteteve. Dy shtete kanë adoptuar një plan të veprimit për regjistrimin, ndërsa vetëm Serbia ka adoptuar një plan të veprimit për të kthyerit dhe ri-integrimin ose për pjesëmarrjen dhe përfaqësimin. Siguria, policia dhe drejtësia, në anën tjetër, shfaqet së bashku si nën-seksion te planet e veprimit të tri shteteve.

## *2.2.Arsimi në politikat për romët, ashkalinë dhe egjiptianët*

Siç është përmendur më lartë, arsimi shfaqet si një nga 11 sektorët në *Strategjinë* momentale për romët, ashkalinë dhe egjiptianët, dhe si një nga nëntë sektorët në *Planin* e ndërlidhur të *Veprimit*. Qëllimi i përgjithshëm për këtë sektor është të nxisë “themelimin e një sistemi gjithëpërfshirës dhe të cilësisë së lartë të arsimit, të bazuar në drejtësi, barazi dhe respekt për diversitet, që kontribuon në integrimin e plotë të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë në shoqërinë kosovare.” Përderisa hapësira që i përkushtohet arsimit përbën vetëm diku rreth shtatë për qind të Strategjisë, arsimi përbën afro një të katërtën e faqeve totale si në *Planin e Veprimit* po ashtu edhe në *Kornizën e Prioriteteve 2014-2015*.

Seksioni që i përkushtohet arsimit në *Planin e Veprimit*, e që mbulon periudhën 2009-2015, përfshin në total 25 aktivitete të organizuara nën katër objektiva. *Korniza e Prioriteteve 2014-2015*, mban të gjitha përveç një aktiviteti të *Planit të Veprimit* dhe shton tetë rekomandime të përbashkëta nga BE-ja dhe Ministria e Integritimit Evropian për zbatim në një periudhë prej më pak se dy vite. Evidenca në dispozicion sugjeron se kjo ngjeshje e afatit kohor nga *Plani i Veprimit* tek *Korniza e Prioriteteve* ka qenë shumë joreale.

Qëllimi dhe objektivat për sektorin e arsimit në *Strategji* dhe *Plan të Veprimit* janë paraqitur në Kutinë 1. Pasi që do të bëhet më e qartë në Seksionin 3 të këtij raporti, kjo gamë e qëllimeve dhe e objektivave mbetet relevante edhe pse afatit kohor të *Strategjisë* aktuale po i afrohet fundit.

### **Kutia 1. Qëllimi dhe objektivat për sektorin e arsimit në *Strategji dhe Plan të Veprimit 2009-2015***

**Qëllimi:** Të themelohet një sistem gjithëpërfshirës dhe i cilësisë së lartë i arsimit, bazuar në drejtësi, barazi dhe respekt për diversitet, që kontribuon në integrimin e plotë të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë në shoqërinë kosovare.

**Objektivi 1:** Përmirësimi i konsiderueshëm i pjesëmarrjes në sistemin e arsimit dhe i cilësisë së arsimit për anëtarët e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë

**Objektivi 2:** Parandalim i diskriminimit dhe ndarjes në sistemin e arsimit

**Objektivi 3:** Bashkëpunim cilësor dhe efikas në mes institucioneve dhe organizatave relevante drejt arsimit të anëtarëve të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë

**Objektivi 4:** Ngritja e vetëdijesimit të komuniteteve dhe palëve me interes për të mbështetur arsimin e anëtarëve të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë

*Burimi:* Qeveria e Republikës së Kosovës

### **3. Zbrazëtirat e mbetura në pjesëmarrjen në arsim**


#### *3.1. Dokumentimi i zbrazëtirave*

Në dritë të mbulimit të saj tematik dhe mostrave të saj të amvisërive romë, ashkali dhe egjiptiane, Anketa Grupore me Shumë Tregues e Kosovës (MICS) 2013-2014 ofron pasqyrën më të freskët të zbrazëtirave në pjesëmarrje në mes romëve, ashkalive dhe egjiptianëve në njërën anë dhe popullatës së përgjithshme në anën tjetër, nga niveli para-shkollor deri te arsimit i mesëm.<sup>15</sup> Një përqendrim relativisht i ngushtë në pjesëmarrjen në arsim e jo në arsimin në përgjithësi, reflekton nevojën që dokumentet e politikave kombëtare të projektohen rreth adresimit të problemeve specifike përmes një qasjeje holistike dhe të koordinuar që lejon që përparimi të matet. Në këtë mënyrë, dokumentet e politikave nuk përbëjnë vetëm deklarata të parimit, por edhe angazhime për të arritur qëllime të qarta dhe konkrete, dhe duke bërë këtë, për të bërë një ndryshim të vërtetë në jetën e atyre që janë synim.

Siç paraqitet në Grafikon 1, Romët, Ashkalitë dhe Egjiptianët kanë më pak qasje në çdo nivel të arsimit dhe norma më të larta të braktisjes se sa popullata e përgjithshme. Përderisa, normat në rënie të pjesëmarrjes nga arsimit fillor në arsimin e mesëm të ulët dhe nga arsimit i mesëm i ulët në arsimin e mesëm të lartë për romët, ashkalitë dhe egjiptianët dhe për popullsinë e përgjithshme janë tipike edhe për shtetet fqinje të Kosovës (siç janë zbrazëtirat në rritje në pjesëmarrje nga një nivel në tjetrin), një tipar veçanërisht i rëndësishëm i gjetjeve të MICS-së është se pjesëmarrja e romëve, ashkalive dhe egjiptianëve është më e lartë dhe zbrazëtira në raport me popullatën e përgjithshme më e vogël në arsimin parashkollor se në arsimin e mesëm.

Në nivel më të përgjithshëm, gjetjet e MICS-së sugjerojnë disa përmirësime në vijimin e shkollës në mesin e fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë që nga adoptimi i *Strategjisë* dhe *Planit të Veprimit*. Në të njëjtën kohë, ato tregojnë se fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë shpesh nuk marrin mbështetje të nevojshme në nxënie jashtë shkollës, ashtu që pjesëmarrja e tyre nuk rezulton domosdoshmërisht në nxënie efektive.

**Grafiku 1. Pjesëmarrja në arsim në mes romëve, ashkalive dhe egjiptianëve dhe në popullatën e përgjithshme**



Burimi: Agjencia Kosovare e Statistikave

### 3.2. Shpjegimi i zbrazëtirave

Zbrazëtitë e vërejtura në pjesëmarrje në arsim në mes romëve, ashkalive dhe egjiptianëve në njërin anë dhe popullatës së përgjithshme në anën tjetër janë rezultat i pozitës tejet të pafavorshme socio-ekonomike të romëve, ashkalive dhe egjiptianëve. Ky disavantazh socio-ekonomik ndërthuret me dallimet kulturore mes këtyre popullsive dhe popullatës shumicë për ta bërë qasjen në arsim edhe më të rëndësishme për integrimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë. Në të njëjtën kohë, edhe prindërit romë, ashkali dhe egjiptianë e po ashtu dhe institucionet përkatëse janë shpesh të pajisura dobët për të siguruar përfshirje efektive. Faktorët më specifikë që ndikojë në pjesëmarrjen më të ulët të romëve, ashkalive dhe egjiptianëve në arsim, në krahasim me popullatën e përgjithshme, janë përshkruar më poshtë.

**Qasja në arsimin parashkollor.** Edhe nëse më shumë fëmijë romë, ashkali dhe egjiptianë vijnë në arsimin parashkollor se që vijnë në arsimin e mesëm, fakti se gati gjysma e romëve, ashkalive dhe egjiptianëve *nuk* vijnë në mësimin parashkollor ndërthuret me dallime më të mëdha në mes mjedisit kulturor dhe gjuhësor në shtëpi dhe atij në shkollë, duke i lënë fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë në një disavantazh më të madh në krahasim me fëmijët nga popullata shumicë që nuk e ndjekin arsimin parashkollor. Edukimi parashkollor nuk është as i detyrueshëm e as pa pagesë,

dhe kapaciteti i programeve parashkollore është më i vogël se numri i fëmijëve të moshës parashkollore.

Kostot e vijimit të shkollës. Për aq sa një pjesë e madhe e popullatës romë, ashkali dhe egjiptiane jetojnë në varfëri, shpenzimet për libra, veshje, ushqim, mjete shkollore si dhe të udhëtimit që lidhen me pjesëmarrjen në arsim janë shpesh penguese.

Puna e fëmijëve. E lidhur ngushtë me kostot e vijimit të shkollës, varfëria e shumë familjeve romë, ashkali dhe egjiptiane luan një rol kyç në pritjet që fëmijët e moshës shkollore (sidomos nga moshë 10 vjeçare) të fitojnë të ardhura për familjen nëpërmjet aktiviteteve të tilla si mbledhja e materialeve të riciklueshme, shitja e mallrave të konsumit dhe larja e dritareve të veturave.

Rolet gjinore. Pjesëmarrja e vajzave romë, ashkali dhe egjiptiane në arsim ndikohet negativisht nga praktikatat si martesat e hershme, veshja e shamisë (si faktor i ngacmimit), dhe pritjet që vajzat më të rritura të qëndrojnë në shtëpi për t'u kujdesur për vëllezërit dhe motrat e tyre më të vegjël, derisa prindërit e tyre të gjenerojnë të ardhura për familjen.

Barrierat gjuhësore. Në rastin e romëve (por jo të ashkalive ose egjiptianëve), mungesa e arsimit në gjuhën amtare rezulton në vështirësi në vitet e para të shkollës dhe këto vështirësi reflektohen me një bazë të njohurive të pamjaftueshme në vitet e mëvonshme.

Migrimi. Dëshmi të konsiderueshme jozyrtare tregojnë se romët, ashkalitë dhe egjiptianët janë të mbi-përfaqësuar në mesin e personave të zhvendosur dhe të kthyer, aq sa fëmijët romë, ashkali, dhe egjiptianë shpesh nuk kanë dokumentacionin e nevojshëm si dhe përvojë me sistemin arsimor të Kosovës.

Informimi. Institucionet e ndryshme përgjegjëse për të siguruar që të gjithë fëmijët janë në shkollë rrallë fillojnë komunikimin me familjet, qoftë për të inkurajuar pjesëmarrjen në arsim ose për të vendosur sanksione për mos-pjesëmarrje.

Nivelet e arsimit të prindërve. Si rezultat i niveleve të ulëta të arsimimit, disa prindër romë, ashkali dhe egjiptianë nuk janë mjaft të vetëdijshëm për rëndësinë e arsimit në mirëqenien e fëmijëve të tyre. Të njëjtat nivele të ulëta të arritjeve arsimore shpesh përbëjnë një problem edhe aty ku vetëdija nuk përbën, pasi prindërit nuk janë në gjendje t'u japin fëmijëve të tyre përkrahjen e nevojshme në kryerjen e detyrave shkollore.

Kushtet e shkollës. Mësimdhënësit shpesh nuk japin mbështetje për fëmijët në nevojë, duke përfshirë fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë. Më tej, shkollat zakonisht nuk organizojnë orët shtesë të kërkuara ligjërisht.

Vetë-besimi. Nivelet e ulëta të vetë-besimit nga ana e shumë fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë, si anëtarë të një pakice të dukshme dhe të pafavorizuar ndikojnë negativisht në performancën e tyre në shkollë, si dhe në marrëdhëniet e tyre me mësimdhënësit dhe me shokët e tyre nga popullata shumicë.



## 4. Raportimi mbi zbatimin e Strategjisë

### 4.1. Korniza e raportimit vjetor

Duke iu falënderuar në një pjesë të madhe asistencës teknike të ofruar nga UNICEF-i për Zyrën për Qeverisje të Mirë (ZQM) në zhvillimin e sistemit të monitorimit dhe raportimit, cilësia e raportimit për zbatimin e *Strategjisë* është përmirësuar dukshëm që nga viti 2012.<sup>16</sup> Ndoshta më e dukshme është se raportimi është bërë më konkret dhe më specifik, siç është reflektuar në rritjen e raportit të treguesve për të cilat u raportuan të dhënat: nga 72 për qind në vitin 2012 në 79 për qind në vitin 2014. Të dhënat në dispozicion sa i përket buxhetit për zbatimin e *Strategjisë* gjithashtu janë rritur gjatë periudhës së njëjtë.

Pa i anashkalluar përmirësimet në kornizën për raportim mbi zbatimin e *Strategjisë* dhe aplikimit të tyre në prodhimin e raporteve vjetore që nga viti 2012, ende kanë mbetur disa sfida. Së pari, megjithëse treguesit dhe të dhënat statistikore janë bërë pjesë përbërëse e metodologjisë së raportimit, vlerësimi i statusit të treguesve komplikohet për shkak të krahasueshmërisë së kufizuar të të dhënave në dispozicion. Në të njëjtën mënyrë, të dhënat në dispozicion për alokimin e buxhetit janë të kufizuara, siç është edhe informacioni i vlefshëm sa i përket kontributeve specifike të alokimeve për zbatimin e *Strategjisë*. Përgatitja e raporteve vjetore nga ZQM-ja është edhe më e komplikuar për shkak të mungesës së modelit të unifikuar për raportim mbi zbatimin e *Strategjisë*, nga ministritë e linjës tek ZQM-ja. Për më tepër, nuk ekziston një sistem për verifikimin e informacionit të pranuar nga institucionet relevante, qoftë nga një institucion tjetër qoftë nga organizatat e shoqërisë civile. Në fund, procesi i raportimit - ashtu si zbatimi i *Strategjisë* në përgjithësi - ndikohet në mënyrë negative nga dobësia e koordinimit në mes ZQM-së dhe ministrive të linjës që janë drejtpërdrejtë përgjegjëse për zbatimin e masave relevante të parapara në *Strategji*.

### 4.2. Raportimi për arsimin

Përmirësimet në raportimin mbi zbatimin e *Strategjisë* në përgjithësi janë të dukshme gjithashtu në lidhje me sektorin e arsimit, me një pjesëmarrje të treguesve të arsimit për të cilat të dhënat kanë raportuar një rritje nga 73 për qind në vitin 2012 në 78 për qind në vitin 2014. Me sa duket, çka i ka kontribuar këtij zhvillimi pozitiv është zvogëlimi në numër i treguesve të arsimit nga 101 në vitin 2012 në 77 në vitin 2014, e që ka zvogëluar në mënyrë efektive barrën e ndërlidhur me raportimin. Gjithashtu rritje në mes viteve 2012 dhe 2014 është shënuar edhe në disponueshmërinë e të dhënave për alokimet buxhetore dhe shpenzimet në lidhje me arsimin. Përderisa nivelet e raportuara të shpenzimeve nga MASHT-i kanë qenë gati konstante në 2013 dhe 2014 (231 000 EUR dhe 232 000 EUR përkatësisht), pjesëmarrja totale e MASHT-it në shpenzimet totale për zbatimin e *Strategjisë* kanë rënë nga 14 për qind në tetë për qind nga njëri vit në tjetrin.

Ndoshta edhe jo aq befasuese, çfarë arsimit gjithashtu ka të përbashkët me sektorët e tjerë të *Strategjisë* është se madje edhe praktikata e përmirësuar të raportimit lënë disa nevoja urgjente të paplotësuara. Për shembull, teksti i raportit vjetor për vitin 2014 e bën të qartë që disa aktivitete relevante për dispozitat e *Strategjisë* në fushën e arsimit janë zbatuar, mirëpo nuk ka lidhje të qartë në mes tekstit të raportit dhe 24 aktiviteteve të numëruara dhe tetë Rekomandimeve të Kornizës së prioritetive 2014-2015 të BE/MIE-së. Si rezultat, deri ku *Strategjia* është zbatuar

nuk mund të vlerësohet aty për aty, për shkak se informacioni mbi ndikimin e *Strategjisë* është shumë i pakët. Ndërsa, një shembull konkret për mungesën e qartësisë dhe konsistencës, që është karakteristikë e raportimit vjetor, është dhënë në Kutinë 2, e edhe më problematike është mungesa e plotë dhe e pashpjegueshme e raportimit për vitin 2014 sa i përket një objektiv të sektorit të arsimit, përkundër faktit se tri nga katër aktivitetet e parapara nën këtë objektiv ishin të planifikuara për zbatim në vitin 2014 nën *Kornizën e Prioriteteve*.<sup>17</sup>

Një tjetër nevojë e paplotësuar e sistemit të ri të raportimit lidhet me raportimin e të dhënave sasiore. Në përgjithësi, shifrat e përfshira në raportet vjetore janë numra absolutë, ashtu që i tregojnë lexuesit se sa persona kanë përfituar nga një masë e caktuar. Duke marrë parasysh se përmirësimi i situatës së romëve, ashkalive dhe egjiptianëve ka të bëjë me mbulimin e pjesëmarrjes së shtuar të këtyre popullatave me anë të masave mbështetëse, të dhënat sasiore janë më relevante gjatë përcjelljes së informacionit mbi raportin e mbulimit.

Raporti vjetor për vitin 2014 gjithashtu përmban tri rekomandime për sektorin e arsimit:

- “Ekziston një nevojë për angazhim më të madh të komunave për zbatimin e Planit të Veprimit”;
- “Bashkëpunim më i madh në mes sektorëve dhe autoriteteve komunale”; dhe
- “MASHT-i duhet të vazhdojë të ofrojë bursa dhe të shqyrtojë numrin në rritje ashtu që nxënësit nga komunitetet romë, ashkali dhe egjiptianë të jenë pjesëmarrës në shkollë të mesme.”<sup>18</sup>

Përderisa rekomandimet mund të duken të arsyeshme, mungesa e çfarëdo përmendjeje në tekstin paraprak të raportit sa i përket problemeve që këto qasje mund të ndihmojnë që të zgjidhen, e len të paqartë se si zbatimi i rekomandimeve mund të pritët t’i kontribuojë realizimit të katër objektivave për arsim të *Strategjisë*.

## Kutia 2. Raportimi për një objektiv arsimor të Planit të Veprimit

Plani i Veprimit i Republikës së Kosovës për zbatimin e Strategjisë për integrimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë parasheh katër aktivitete dhe po aq veprime drejt zbatimit të objektivit të dytë në sektorin e arsimit “Parandalimin e diskriminimit dhe ndarjes në sistemin e arsimit”, siç është paraqitur më poshtë.

Aktiviteti	Veprimet
2.1. Analiza dhe gjendja e momentale sa i përket ndarjes dhe diskriminimit në arsim	2.1.1. MASHT-i në partneritet me OJQ-të, organizon hulumtim sa i përket prezencës së ndarjes dhe të diskriminimit ndaj komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë në sistemin e arsimit në Kosovë.
2.2. Parandalimi i ndarjes dhe i diskriminimit përmes akteve ligjore	2.2.1. Miratimi i akteve dhe direktivave administrative për parandalimin e akteve të ndarjes
2.3. Trajnimi për punonjës dhe zyrtarë të arsimit në eliminimin e paragjykimit	2.3.1. Punonjësit dhe zyrtarët e arsimit janë të trajnuar në eliminimin e temave të paragjykimit, si dhe në programet e tolerancës ndër-etnike dhe ndër-kulturore.
2.4. Ngritja e vetëdijes së komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë për format e diskriminimit dhe ndarjes në arsim	2.4.1. Ndërtimi i kapaciteteve të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë për të njohur ndarjen në arsim, vërtetimin e saj dhe veprimet pasuese.

*Raporti i Vlerësimit të ZQM-së i Kornizës së Prioriteteve për periudhën 2014 mbi Zbatimin e Planit të Veprimit dhe Strategjisë së Republikës së Kosovës për Integrimin e Komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptianë, 2014-2015 ofron informacionet në vijim sa i përket zbatimit të aktiviteteve drejt realizimit të këtij objekti:*

### **Objektivi 1.2: Parandalimi i diskriminimit dhe ndarjes në sistemin e arsimit**

Në shkolla janë organizuar punëtori për mësimdhënës sa i përket eliminimit të paragjyimeve, gjithashtu 6 zyrtarë dhe 6 punonjës të arsimit që janë trajnuar për eliminimin e paragjykimit. Mirëpo, ende nuk është bërë një analizë e situatës sa i përket ndarjes dhe diskriminimit në arsim përbrenda kornizës së prioriteteve.

Vitin e kaluar, pas reagimit të shpejtë nga MASHT-i në bashkëpunim me DKA-në sa i përket vendosjes së nxënësve nga komunitetet romë, ashkali dhe egjiptianë në paralele të ndarë, nuk ka pasur rast të ndarjes në shkolla. Nxënësit romë, ashkali dhe egjiptianë vijnë shkollën së bashku me nxënës nga komunitetet shumicë.

Nuk ka pasur pengesa në arritjen e këtij objekti. Politikat qeveritare për arsimin janë në përputhje me objektivin dhe këto politika zbatohen drejtpërsëdrejti në klasa.

Informacioni i raportuar është qartazi relevant për objektivin. Më veçanërisht, narrativi ofron informacione për zbatimin e dy aktiviteteve të planifikuara nën këtë objektiv (edhe pse pa u përdorur numërimi në *Planin e Veprimit*):

- Janë mbajtur punëtoritë në temën e kundër-diskriminimit për mësimdhënësit dhe punonjësit e arsimit, ashtu që Aktiviteti 2.3 është zbatuar.
- Analiza e ndarjes dhe diskriminimit e paraparë nën Aktivitetin 2.1 nuk është kompletuar.

Megjithatë, në të njëjtën kohë narrativi i mungojnë informacione për statusin e dy aktiviteteve të tjera të planifikuara (d.m.th. Aktivitetet 2.2 dhe 2.4)

## 5. Konkluzione

### 5.1. Rishikimi i çështjeve kyçe

Arsimi është edhe një e drejtë njerëzore universale por edhe një kusht i domosdoshëm për një shoqëri moderne funksionale dhe përparuese. Në kontekstin e Kosovës, arsimi është po ashtu i një rëndësie të veçantë për shkak të kontributit të tij në institucionalizimin dhe normalizimin e marrëdhënieve shoqërore, ashtu si edhe integrimin e përgjithshëm të personave që qëndrojnë në margjinat e shoqërisë. Roli qendror dhe i shumëfishtë i arsimit në mënyrë adekuate është njohur në dokumentet e politikave të nxjerra si nga institucionet e Kosovës, po ashtu edhe në deklaratat e përfaqësuesve të këtyre institucioneve në konferencën e mbajtur në prill të vitit 2014 ku u dha shtypa për formimin e Grupit të Reflektimit mbi arsimin e të kthyerve të detyruar dhe të romëve, ashkalive dhe egjiptianëve.

Duke marrë parasysh faktin se *Strategjia për integrimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë në Republikën e Kosovës* dhe *Plani* i ndërlidhur i *Veprimit* në vitin 2015, puna e Grupit të Reflektimit përgjatë vitit është përqendruar në sistematizimin e nxënies nga përvoja e zbatimit të *Strategjisë* dhe *Planit të Veprimit*, me një sy kah kontributi në dokumentin e politikës që do ta zëvendësojë *Strategjinë* aktuale. Temat e takimeve të Grupit të Reflektimit në vitin 2015 reflektojnë këto theksime: statusi i zbatimit të *Strategjisë*; korniza e raportimit vjetor për *Strategjinë*; dhe ndërtimi i strategjisë holistike për arsimin e romëve, ashkalive dhe egjiptianëve.

*Strategjia* dhe *Plani i Veprimit* të Kosovës mbulojnë një numër më të madh të sektorëve, se që bëjnë dokumentet korresponduese të shumicës së shteteve fqinje të Kosovës dhe shteteve anëtare të BE-së që janë pjesëmarrëse në Dekadën e Përfshirjes së Romëve. Megjithatë, mbulimi i arsimit është i përbashkët për të gjithë, me arsimin si një nga 11 sektorët e *Strategjisë* dhe një nga nëntë sektorët e *Planit të Veprimit*. Për realizimin e qëllimit të përgjithshëm të krijimit të një sistemi arsimor që kontribuon në integrimin e plotë të romëve, ashkalive dhe egjiptianëve në shoqëri, *Plani i Veprimit* përfshinë 25 aktivitete nën katër objektiva. *Korniza e Prioriteteve 2014-2015* i ngjesh të gjitha aktivitetet, përpos njëjës, në një kornizë kohore shumë më të shkurtër, ndërsa në të njëjtën kohë i shton tetë rekomandime të përbashkëta nga BE-ja dhe Ministria për Integrimin Evropian. Edhe pse afatit kohor të kësaj *Strategjie* po i afrohet fundit, qëllimi dhe objektivat e *Strategjisë* mbesin relevante.

Gjetjet e Anketës Grupore me Shumë Tregues të Kosovës 2013-2014 tregojnë se romët, ashkalitë dhe egjiptianët kanë më pak qasje në çdo nivel të arsimit dhe norma më të larta të braktisjes se sa popullata e përgjithshme. Zbrastitë e vërejtura në pjesëmarrje në arsim në mes romëve, ashkalive dhe egjiptianëve në njërin anë dhe popullatës së përgjithshme në anën tjetër, janë rezultat i pozitës tejet të pafavorshme socio-ekonomike të romëve, ashkalive dhe egjiptianëve. Ky disavantazh socio-ekonomik ndërthuret me dallimet kulturore në mes këtyre popullsive dhe popullatës shumicë për ta bërë qasjen në arsim edhe më të rëndësishme për integrimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë. Në të njëjtën kohë, si prindërit romë, ashkali dhe egjiptianë ashtu dhe institucionet përkatëse janë shpesh të pajisura dobët për të siguruar përfshirje efektive.

Përderisa cilësia e raportimit për zbatimin e Strategjisë është përmirësuar mjaft që nga viti 2012, megjithatë sfidat janë të dukshme në lidhje me dokumentin si tërësi dhe me sektorin e arsimit në veçanti. Si rezultat, deri ku *Strategjia* është zbatuar nuk mund të vlerësohet aty për aty, për shkak se informacioni mbi ndikimin e *Strategjisë* është shumë i pakët. Për më tepër, baza për rekomandimet e ofruara në raportet vjetore për zbatimin e *Strategjisë* është e paqartë.

## 5.2. Rekomandime

Bazuar në seksionet paraprake të këtij raporti, rekomandimet e mëposhtme kanë për qëllim që të ofrojnë një bazë për finalizimin e masave të ndërlidhura me arsimin të këtij dokumenti të politikës që do ta zëvendësojë *Strategjinë për integrimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë në Republikën e Kosovës dhe Planin e ndërlidhur të Veprimit*.

Të përgjithshme:

5.2.1. *Të ndërmerret një qasje holistike në nivel qendror.* ZQM-ja duhet t'i sjellë së bashku institucionet dhe organizatat relevante për të siguruar koordinimin në përgatitjen dhe zbatimin e dokumentit të politikës së re. Në të njëjtën kohë, bashkëpunimi në mes Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale duhet të forcohet për të lidhur më mirë ndihmën sociale për prindërit me pjesëmarrjen e fëmijëve në arsim. Ministrinë e tjera kyçe për zhvillimin e një qasjeje holistike për arsimin e romëve, ashkalive dhe egjiptianëve në Kosovë përfshijnë Ministrinë për Komunitete dhe Kthim dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme.

5.2.2. *Sigurimi i koordinimit në nivel lokal.* Me mbështetjen e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, si dhe organizatat përkatëse të shoqërisë civile, Drejtoritë Komunale të Arsimit duhet të rrisin përqendrimin e tyre në shkollat e vijuar nga fëmijët që i përkasin komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë. Grupi me mandat ligjor (dhe multi-sektorial) për parandalimin e braktisjes së shkollës duhet të jetë funksional në çdo shkollë. Gjithashtu duhet t'i kushtohet vëmendje krijimit të mekanizmave të dedikuara në nivel komunal, për koordinimin e zbatimit të politikave të nivelit qendror për romët, ashkalitë dhe egjiptianët, duke aplikuar mësimet e nxjerra nga modeli i Qendrave Informativë për Romë që përdoren në Maqedoni.

Ngritja e pjesëmarrjes në arsim:

5.2.3. *Angazhimi i prindërve.* Organizatat e shoqërisë civile duhet të punojnë në motivimin e prindërve për të mbështetur arsimin e fëmijëve të tyre. Përveç kësaj, anëtarët e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë duhet të përfshihen në këshillat e shkollës dhe këshillat e prindërve.

5.2.4. *Ofrimi i arsimit për të rritur.* Me synimin për t'iu mundësuar prindërve romë, ashkali dhe egjiptianë për të mbështetur arsimin e fëmijëve të tyre në mënyrë më efektive si dhe për të konkurruar në mënyrë më efektive në tregun e punës, duhet të përgatiten dhe të ofrohen programe arsimore për të rriturit.

5.2.5. *Përmirësimi i qasjes në arsim para-shkollor.* Duke marrë parasysh rëndësinë e arsimit parashkollor për të arriturat e mëvonshme shkollore të fëmijëve, mjedisi kulturor dhe gjuhësor i të cilëve në shtëpi është i ndryshëm nga ai i shumicës, si dhe faktin se ky nivel i arsimit do të bëhet së shpejti i detyrueshëm, duhet të rritet vëmendja në arsimin parashkollor për fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë.

5.2.6. *Institucionalizimi i Qendrave Mësimore. Rolet e Qendrave Mësimore dhe ndërmjetësve përkatës në përmirësimin e pjesëmarrjes së fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë në shkollë përmes masave që përfshijnë përgatitjen parashkollore dhe ofrimin e orëve shtesë në arsimin fillor, duhet të transferohen tek struktura shtetërore. Duke vepruar kështu, duhet pasur kujdes të veçantë për të siguruar që motivimi i ofruar nëpërmjet Qendrave Mësimore për komunitetet lokale të romëve, ashkalive dhe egjiptianëve (siç dëshmohet nga pjesëmarrja më e lartë e romëve, ashkalive dhe egjiptianëve në arsimin parashkollor në krahasim me arsimin e mesëm) të ruhet edhe pas transferimit.*

5.2.7. *Përgatitja e shkollave për fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë. Personelit të shkollës duhet t'i ofrohen trajnime për arsimin gjithëpërfshirës të nevojshëm që t'iu mundësojë atyre për të shërbyer, për t'i adresuar nevojat arsimore dhe për të shërbyer si shembuj të mirë për të gjithë nxënësit, pavarësisht përkatësisë së komunitetit.*

5.2.8. *Prezantimi i shembujve të mirë dhe pozitivë romë, ashkali dhe egjiptianë. Përtej masave të ndërmarra në shkolla, Organizatat e Shoqërisë Civile kanë një rol të rëndësishëm në ndërtimin e vetë-besimit në mes fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë duke iu dhënë atyre shembuj të të rriturve nga komunitetet e tyre përkatëse, të cilët kanë arritur sukses në bazë të arsimit të tyre.*

#### Përmirësimi i raportimit dhe planifikimit:

5.2.9. *Konsolidimi i koordinimit. Duhet të krijohet një njësi e dedikuar me autoritet dhe burime të mjaftueshme (edhe njerëzore e edhe materiale) për të koordinuar aktivitetet e institucioneve të nivelit qendror të përfshira në zbatimin e politikave për romë, ashkali dhe egjiptianë; të mbikëqyret zbatimin e politikave relevante në nivel lokal; të organizohen vlerësime të jashtme të rregullta për masat e zbatuara drejt realizimit të prioritetëve të politikave; dhe të mblidhen, sintetizohen dhe të shpërndahen informacione për sa i përket zbatimit. Njësia duhet të përbëhet aq sa është e mundur nga romë, ashkali dhe egjiptianë të kualifikuar.*

5.2.10. *Institucionalizimi i komunikimit në mes institucioneve relevante. Me një sy kah maksimizimi i mundësisë së Grupit Punues Teknik të Planit të Veprimit ose pasardhësve të tyre për të koordinuar, shkëmbyer informacione, monitoruar dhe për të caktuar prioritetet në lidhje me politikën për romë, ashkali dhe egjiptianë, përbërja e këtij grupi duhet të përfshijë institucionet kyçe përgjegjëse për të gjithë sektorët e dokumentit të politikës së re. Agjencia e Statistikave e Kosovës duhet të përfshihet në këtë grup.*

5.2.11. *Fokusi në ndikim. Të dhënat e raportuara mbi gjendjen e romëve, ashkalive dhe egjiptianëve duhet të krahasohen me vlerat bazë të përfshira në dokumentet strategjike, duke nxjerrë mësim nga aty ku mungesa e ndikimit ose ndikimi negativ është i dukshëm.*

5.2.12. *Përfshirja e shoqërisë civile. Përfshirja e shoqërisë civile në faza të ndryshme si në ofrimin e kontributit ose verifikimin e të dhënave mund të kontribuojë në cilësinë e raportimit. Këshillimet e Komisionit Evropian me organizatat e shoqërisë civile kanë ofruar një model pozitiv në këtë drejtim.*

5.2.13. *Rekomandimet bazë*. Rekomandimet e ofruara në raporte duhet të lidhen në mënyrë eksplicite me të dhënat e raportuara për sa i përket realizimit të objektivave relevante.

5.2.14. *Lidhja e raportimit me planifikim*. Në mënyrë që të lejohet marrja parasysh e gjetjeve të raportit vjetor në aktivitetet e planifikimit dhe të alokimeve shoqëruese të buxhetit për vitin pasues, procesi i raportimit duhet të kryhet jo më vonë se fundi i tremujorit të parë të atij viti. Datat e pritura të publikimit do të bëhen të njohura shumë më përpara, me një sy kah lehtësimi i përgjigjes së koordinuar ndaj gjetjeve.

## Fusnotat

<sup>1</sup> Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, *Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut* (Paris: Kombet e Bashkuara, 1948), Neni 26.

<sup>2</sup> Komiteti i Ministrave, *Rekomandimi CM/Rec (2007)6 i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare mbi Përgjegjësinë Publike për Arsim të Lartë dhe Hulumtim* (Strasburg: Këshilli i Evropës, 2007), Neni 5.

<sup>3</sup> Shih Klemen Mikllaviç, *Konferenca mbi Arsimin e të Kthyerve dhe Komunitetet Romë, Ashkali dhe Egjiptianë: Sfidat dhe zgjidhjet*. Raporti i Përgjithshëm (Prishtinë: Këshilli i Evropës, 2014), Neni 3.

<sup>4</sup> Pavarësisht nga dallimet në mes romëve, ashkalive dhe egjiptianëve ashtu si edhe romëve, ashkalive dhe egjiptianëve në njërin anë dhe të kthyerve të detyruar në anën tjetër, ekziston një përputhje në mes të pjesëtarëve në kategorinë “romë, ashkali dhe egjiptianë” dhe “të kthyerve të detyruar” dhe në nevojat e romëve, ashkalive dhe egjiptianëve të marra si grupe të dalluara.

<sup>5</sup> Shih Klemen Mikllaviç, *Konferenca mbi Arsimin e të Kthyerve dhe Komunitetet Romë, Ashkali dhe Egjiptianë: Sfidat dhe zgjidhjet*. Raporti i Përgjithshëm (Prishtinë: Këshilli i Evropës, 2014), Neni 2.

<sup>6</sup> *Po këtu*, fq. 2-3.

<sup>7</sup> Objektivi themelor i ACCESS është që të sigurojë kohezion dhe besim social në mesin e komuniteteve dhe të promovojë zhvillimin socio-ekonomik të të kthyerve të pafavorizuar si dhe romëve, ashkalive dhe egjiptianëve në Kosovë. Projekti synon mbështetjen e masave aktive të ndërmarra për të siguruar integrimin dhe përfshirjen e këtyre komuniteteve në sistemin arsimor në përgjithësi dhe shkollimin në veçanti, duke u përqendruar në tri kategori të përfituesve të drejtpërdrejt: Komunitetet romë, ashkali dhe egjiptianë; të kthyerit e detyruar nga komunitetet romë, ashkali dhe egjiptianë; dhe të kthyerit e detyruar nga komunitetet e tjera. ACCESS kërkon që të ndërtojë kapacitetet e institucioneve lokale përmes përfshirjes së drejtpërdrejt të autoriteteve të Kosovës në aktivitetet e veta, duke synuar qasjen në arsimin formal dhe vijimin e rregullt në shkollë për komunitetet romë, ashkali dhe egjiptianë dhe të kthyerve të detyruar; integrimin e parimeve të arsimit gjithëpërfshirës dhe ndërkulturor në politikat shkollore; integrimin e romëve, ashkalive dhe egjiptianëve si dhe të kthyerve të detyruar në komunitetet lokale me një rrjet lokal efektiv për mbështetje sociale; si dhe njohjen e gjuhës rome në shkolla dhe promovimin e saj edhe si e drejtë por edhe si mjet për ndërtimin e një identiteti pozitiv për fëmijët romë.

<sup>8</sup> Shih Qeveria e Republikës së Kosovës, *Strategjia për integrimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë në Republikën e Kosovës, 2009-2015* (Prishtinë: Qeveria e Republikës së Kosovës, 2008); *Plani i Veprimit i Republikës së Kosovës për Zbatimin e strategjisë për integrimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë në Republikën e Kosovës, 2009-2015*. (Prishtinë: Qeveria e Republikës së Kosovës, 2009); gjithashtu Zyra për Qeverisje të Mirë, *Raporti i Progresit 2012 mbi Zbatimin e Planit të Veprimit dhe Strategjisë së Republikës së Kosovës për Integrimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë, 2009-2015; Vlerësimi Lokal 2013 dhe Korniza e Prioriteteve 2014-2015*. (Prishtinë: Zyra për Qeverisje të Mirë, 2014).

<sup>9</sup> Shtetet pjesëmarrëse në Dekadën e Përfshirjes së Romëve (2005-2015) të cilat kanë adoptuar strategjinë për romët janë Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Republika Çeke, Hungaria, Maqedonia, Mali i Zi, Rumania, Serbia, Sllovakia, Sllovenia dhe Spanja. Sllovenia dallon nga shtetet e tjera që kanë adoptuar strategjinë për shkak se është vetëm vëzhguese dhe jo anëtar i plotë i Dekadës. Vëzhguesit e tjerë në Dekadë - Moldavia, Norvegjia dhe Shtetet e Bashkuara - nuk kanë adoptuar një strategji për romët. Dekada filloi me një deklaratë nga qeveritë e nëntë shteteve të Evropës Lindore dhe një grup i partnerëve ndërkombëtarë nën udhëheqjen e Institutit për Shoqëri të Hapur dhe të Bankës Botërore me qëllim të “eliminimit të diskriminimit dhe mbylljes së zbrazëtirave të papranueshme në mes romëve dhe pjesës tjetër të shoqërisë.” Shih Komiteti Drejtues Ndërkombëtar, *Dekada e*

*Përfshirjes së Romëve 2005-2015: Termet e Referencës* - (Budapest: Komiteti Drejtues Ndërkombëtar 2005); [www.romadecade.org](http://www.romadecade.org).

<sup>10</sup> Shih Ministria për të Drejtat e njeriut dhe të minoriteteve, *Strategjia për përmirësimin e statusit të romëve në Republikën e Serbisë* (Beograd: Ministria për të Drejtat e njeriut dhe të minoriteteve, 2010);; Vijeće Ministara Bosne i Hercegovine, *Strategjia Bosne i Hercegovine za rješavanje problema Roma [Strategjia e Bosnjes dhe Hercegovinës për zgjidhjen e problemit të romëve]* (Sarajevë: Vijeće Ministara Bosne i Hercegovine 2005).

<sup>11</sup> Shih Ministria për të Drejtat e njeriut dhe të minoriteteve, *Strategjia për përmirësimin e statusit të romëve dhe egjiptianëve në Mal të Zi 2012-2016 (Podgoricë: Ministria për të Drejtat e njeriut dhe të minoriteteve, 2012).*

<sup>12</sup> Shih Qeveria e Republikës së Shqipërisë, *Strategjia Kombëtare për përmirësimin e kushteve të jetës së romëve* (Tiranë: Qeveria e Republikës së Shqipërisë, 2003); Qeveria e Republikës së Sllovenisë, *Programi Kombëtar i Masave për Romët i Qeverisë së Republikës së Sllovenisë për periudhën 2010-2015*, (Lubjanë: Qeveria e Republikës së Sllovenisë, 2010); Qeveria e Rumanisë, *Strategjia e Qeverisë së Rumanisë për përfshirjen e qytetarëve rumunë që i përkasin minoritetit romë* (Bukuresht: Qeveria e Rumanisë, 2011); Qeveria e Republikës së Sllovakisë, *Strategjia e Republikës së Sllovakisë për integrimin e romëve deri në vitin 2020*, (Bratislavë: Qeveria e Republikës së Sllovakisë, 2012); Qeveria e Spanjës, *Strategjia Kombëtare për integrimin e romëve në Spanjë 2012-2020* (Madrid: Qeveria e Spanjës, 2012); Ministri për të Drejtat e njeriut, *Koncepti i integritit të romëve për 2010-2013* (Pragë: Qeveria e Republikës Çeke, 2009); Ministerstvo za trud i socijalna politika, *Strategjia za Romite vo Republika Makedonija 2014-2020 [Strategjia për romët në Republikën e Maqedonisë 2014-2020]* (Shkup: Ministerstvo za trud i socijalna politika, 2014); Ministria për Administrim Publik dhe Drejtësi, *Strategjia Kombëtare për përfshirje sociale: Varfëria e skajshme, varfëria e fëmijëve, romët (2011-2020)* (Budapest: Ministria për Administrim Publik dhe Drejtësi, 2011); Këshilli Kombëtar për bashkëpunim sa i përket çështjeve etnike dhe integritit, *Strategjia Kombëtare për integrimin e romëve të Republikës së Bullgarisë (2012-2020)* (Sofja: Këshilli Kombëtar për bashkëpunim sa i përket çështjeve etnike dhe integritit, 2012); Vlada Republike Hrvatske, *Nacionalna strategjia za uključivanje Roma, za razdoblje od 2013. do 2020 godine [Strategjia Kombëtare për përfshirjen e romëve, për periudhën prej 2013 deri 2020]* (Zagreb: Vlada Republike Hrvatske, 2012).

<sup>13</sup> Së voni, po këto katër tema gjithashtu janë adoptuar nga Komisioni Evropian në thirrjen e saj ndaj shteteve anëtare të BE-së për të adoptuar Strategjitë Kombëtare për integrimin e romëve. Shih Komisioni Evropian, *Një Kornizë e BE-së për Strategjitë Kombëtare për integrimin e romëve deri në vitin 2020. Komunikimi nga Komisioni tek Parlamenti Evropian, Këshilli, Komiteti Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komiteti i Rajoneve COM (2011) 173 final* (Bruksel: Komiteti i Komuniteteve Evropiane, 2011).

<sup>14</sup> Shih Qeveria e Bullgarisë, *Plani kombëtar i Veprimit: Dekada e përfshirjes së romëve 2005-2015* (Sofja: Qeveria e Bullgarisë, 2005); Qeveria e Republikës Çeke, *Dekada e përfshirjes së romëve 2005-2015: Plani kombëtar i Veprimit* (Pragë: Qeveria e Republikës Çeke, 2005); Qeveria e Republikës së Hungarisë, *Plani Strategjik i Programit të Dekadës së përfshirjes së romëve* (Budapest: Qeveria e Republikës së Hungarisë, 2007); Qeveria e Republikës së Sllovakisë, *Plani Kombëtar i Rishikuar i Veprimit i Dekadës së përfshirjes së romëve 2005-2015, për Vitet 2011-2015* (Bratislavë: Qeveria e Republikës së Sllovakisë, 2011); Ministerstvo za ljudska i manjinska prava, *Akcion plan za sprovođenje Strategije za poboljšanje položaja Roma i Egipćana u Crnoj Gori 2012-2016 za 2012. godinu [Plani i veprimit për zbatimin e strategjisë për përmirësimin e pozitës së romëve dhe egjiptianëve në Mal të Zi 2012-2016 për 2012]* (Podgoricë: Ministerstvo za ljudska i manjinska prava, 2012); Ministerstvo za trud i socijalna politika, *Revizija na Nacionalnite akciski planovi od "Dekadata za vključivanje na Romite 2005-2015" i Strategjia za Romite vo Republika Makedonija za period 2009-2011 [Shqyrtimi i planit kombëtar të veprimit të Dekadës së përfshirjes së romëve 2005-2015 dhe Strategjia për romët në Republikën e Maqedonisë për periudhën 2009-2011]* (Shkup: Ministerstvo za trud i socijalna politika, 2009); *Nacionalen akciski plan za unapreduvanje na opštественata položba na Romkite vo R. Makedonija 2011-2013 [Plani Kombëtar i veprimit për Avancimin e pozitës sociale të grave rome në Republikën e Maqedonisë 2011-2013]* (Shkup: Ministerstvo za trud i socijalna politika, 2010); Ministria për të Drejtat e njeriut dhe refugjatë, *Plani i rishikuar i veprimit i Bosnjës dhe Hercegovinës për adresimin e çështjeve rome në fushën e punësimit, banimit dhe kujdesit shëndetësorë 2013-2016* (Sarajevë: Ministria për të Drejtat e njeriut dhe refugjatë, 2010); *Plani i rishikuar i veprimit i Bosnjës dhe Hercegovinës për adresimin e çështjeve rome në fushën e punësimit, banimit dhe kujdesit shëndetësorë 2013-2016* (Sarajevë: Ministria për të Drejtat e njeriut dhe refugjatë, 2013); Ministria e Shëndetit, Politikave Sociale dhe Barazisë, *Plani i veprimit për zhvillimin e popullatës rome 2010-2012* (Madrid: Ministria e Shëndetit, Politikave Sociale dhe Barazisë, 2010); Ministria për të Drejtat e njeriut dhe të minoriteteve, *Strategjia për përmirësimin e statusit të romëve në Republikën e Serbisë* (Beograd: Ministria për të Drejtat e njeriut dhe të minoriteteve, 2010); Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, *Plani Kombëtar i veprimit për dekaden e përfshirjes së romëve 2010-2015* (Tiranë: Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, 2009); Vlada Republike Hrvatske, *Akcijski plan za provedbu Nacionalne strategije za uključivanje Roma,*



za razdoblje od 2013. do 2015. godine [Plani i veprimit për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për përfshirjen e romëve, për periudhën prej 2013 deri 2015] (Zagreb: Vlada Republike Hrvatske, 2013). Rumania dhe Sllovenia nuk kanë adoptuar plane të ndara të veprimit për realizimin e qëllimeve të përcaktuara në strategjitë e tyre përkatëse për romët, mirëpo të dy strategjitë përmbajnë informacione për masat e planifikuara. Shih Qeveria e Republikës së Sllovenisë, *Programi Kombëtar i Masave për Romët i Qeverisë së Republikës së Sllovenisë për periudhën 2010-2015*, (Lubjanë: Qeveria e Republikës së Sllovenisë, 2010); Qeveria e Rumanisë, *Strategjia e Qeverisë së Rumanisë për përfshirjen e qytetarëve rumunë që i përkasin minoritetit romë* (Bukuresht: Qeveria e Rumanisë, 2011).

<sup>15</sup> Kryer nga Agjencia e Statistikave e Kosovës, me përkrahje teknike nga UNICEF-i, Anketa Grupore me Shumë Tregues mbuloi një total prej 4 406 familjeve, duke përfshirë 1 177 familje rome, ashkali dhe egjiptiane. See <http://ask.rks-gov.net/eng/mics>.

<sup>16</sup> Shih Zyra për Qeverisje të Mirë, *Raporti i Progresit 2012 mbi Zbatimin e Planit të Veprimit dhe Strategjisë së Republikës së Kosovës për Integrimin e Komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptianë, 2009-2015; Vlerësimi Lokal 2013 dhe Korniza e Prioriteteve 2014-2015*. (Prishtinë: Zyra për Qeverisje të Mirë, 2014); *Raporti i Katërt i Vlerësimit mbi Zbatimin e Planit të Veprimit dhe Strategjisë së Republikës së Kosovës për Integrimin e Komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptianë, 2013* (Prishtinë: Zyra për Qeverisje të Mirë, 2014); *Raporti i Vlerësimit të Kornizës së Prioriteteve për periudhën 2014 mbi Zbatimin e Planit të Veprimit dhe Strategjisë së Republikës së Kosovës për Integrimin e Komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptianë, 2014-2015* (Prishtinë: Zyra për Qeverisje të Mirë, 2015).

<sup>17</sup> Aktivitetet nën Objektivin 4 (‘‘Ngritja e vetëdijesimit të komuniteteve dhe palëve me interes për të mbështetur arsimin e pjesëtarëve të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë’’) planifikuar për zbatim në vitin 2014 nën *Kornizën e Prioriteteve* ka qenë organizimi i aktiviteteve sportive dhe kulturore (Aktiviteti 1.4.1); promovimi i vlerave, trashëgimisë dhe identitetit të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë (Aktiviteti 1.4.3); dhe ndërtimi i marrëdhënieve të besimit në mes shkollave dhe familjeve (Aktiviteti 1.4.4). Shih Zyra për Qeverisje të Mirë, *Raporti i Progresit 2012 mbi Zbatimin e Planit të Veprimit dhe Strategjisë së Republikës së Kosovës për Integrimin e Komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptianë, 2009-2015; Vlerësimi Lokal 2013 dhe Korniza e Prioriteteve 2014-2015*. (Prishtinë: Zyra për Qeverisje të Mirë, 2014).

<sup>18</sup> *Raporti i Vlerësimit të Kornizës së Prioriteteve për periudhën 2014 mbi Zbatimin e Planit të Veprimit dhe Strategjisë së Republikës së Kosovës për Integrimin e Komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptianë, 2014-2015* (Prishtinë: Zyra për Qeverisje të Mirë, 2015).

## Burimet e konsultuara

- Komiteti i Ministrave. 2007. *Rekomandimi CM/Rec (2007)6 i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare mbi Përgjegjësinë Publike për Arsim të Lartë dhe Huluntim*. Strasburg: Këshilli i Evropës.
- Qeveria e Bullgarisë. 2005. *Plani Kombëtar i Veprimit: Dekada e përfshirjes së romëve 2005-2015*. Sofje: Qeveria e Bullgarisë.
- Qeveria e Rumanisë. 2011. *Strategjia e Qeverisë së Rumanisë për përfshirjen e qytetarëve rumunë që i përkasin minoritetit romë*. Bukuresht: Qeveria e Rumanisë.
- Qeveria e Spanjës. 2012. *Strategjia Kombëtare për integrimin e romëve në Spanjë 2012-2020*. Madrid: Qeveria e Spanjës.
- Qeveria e Republikës Çeke. 2005. *Dekada e përfshirjes së romëve 2005-2015: Plani Kombëtar i Veprimit*. Pragë: Qeveria e Republikës Çeke.
- Qeveria e Republikës së Shqipërisë. 2003. *Strategjia Kombëtare për përmirësimin e kushteve të jetës së romëve*. Tiranë: Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë.
- Qeveria e Republikës së Hungarisë. 2007. *Plani Strategjik i Programit të Dekadës së përfshirjes së romëve*. Budapest: Qeveria e Republikës së Hungarisë.
- Qeveria e Republikës së Kosovës. 2008. *Strategjia për Integrimin e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptianë në Republikën e Kosovës, 2009-2015*. Prishtinë: Qeveria e Republikës së Kosovës.
- \_\_\_\_\_. 2009. *Plani i Veprimit i Republikës së Kosovës për Zbatimin e Strategjisë për Integrimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë në Republikën e Kosovës, 2009-2015*. Prishtinë: Qeveria e Republikës së Kosovës.
- Qeveria e Republikës së Sllovenisë. 2010. *Programi Kombëtar i Masave për Romët i Qeverisë së Republikës së Sllovenisë për periudhën 2010-2015*. Lubjanë: Qeveria e Republikës së Sllovenisë.
- Qeveria e Republikës së Sllovakisë. 2011. *Plani Kombëtar i Rishikuar i Veprimit i Dekadës së përfshirjes së romëve 2005-2015, për Vitet 2011-2015*. Bratislavë: Qeveria e Republikës së Sllovakisë.
- \_\_\_\_\_. 2012. *Strategjia e Republikës së Sllovakisë për integrimin e romëve deri në vitin 2020*. Bratislavë: Qeveria e Republikës së Sllovakisë.
- Komiteti Drejtues i Brendshëm. 2005. *Dekada e përfshirjes së romëve 2005-2015: Termet e Referencës*. Bukuresht: Komiteti Drejtues Ndërkombëtar.
- Agjencia e Statistikave të Kosovës. 2015. ‘‘Anketa Grupore me Shumë Tregues në Republikën e Kosovës 2013-2014’’ Ueb faqja [e qasur më 29 tetor 2015]. Në dispozicion në

<http://ask.rks-gov.net/eng/mics>.

- Miklavič, Klemen. 2014. *Konferenca mbi arsimin e të kthyerve dhe komunitetet romë, ashkali dhe egjiptianë: Sfidat dhe zgjidhjet*. Raporti i përgjithshëm. Prishtinë: Këshilli i Evropës.
- Ministarstvo za ljudska i manjinska prava. 2012. *Akcioni plan za sprovođenje Strategije za poboljšanje položaja Roma i Egipćana u Crnoj Gori 2012-2016 za 2012. godinu [Plani i veprimët për zbatimin e strategjisë për përmirësimin e pozitës së romëve dhe egjiptianëve në Mal të Zi 2012-2016 për 2012]*. Podgoricë: Ministarstvo za ljudska i manjinska prava.
- Ministri për të Drejtat e Njeriut. 2009. *Koncepti për integrimin e romëve për 2010-2013*. Pragë: Qeveria e Republikës Çeke.
- Ministerstvo za trud i socijalna politika. 2009. *Revizija na Nacionalnite akciski planovi od "Dekadata za vključvanje na Romite 2005-2015" i Strategija za Romite vo Republika Makedonija za period 2009-2011 [Shqyrtimi i planit kombëtar të veprimët të Dekadës së përfshirjes së romëve 2005-2015 dhe Strategjia për romët në Republikën e Maqedonisë për periudhën 2009-2011]*. Shkup: Ministerstvo za trud i socijalna politika.
- \_\_\_\_\_. 2010. *Nacionalen akciski plan za unapreduvanje na opštественata položba na Romkite vo R. Makedonija 2011-2013 [Plani Kombëtar i veprimët për Avancimin e pozitës sociale të grave rome në Republikën e Maqedonisë 2011-2013]*. Shkup: Ministerstvo za trud i socijalna politika.
- \_\_\_\_\_. 2014. *Strategija za Romite vo Republika Makedonija 2014-2020 [Strategjia për romët në Republikën e Maqedonisë 2014-2020]*. Shkup: Ministerstvo za trud i socijalna politika.
- Ministria për të Drejtat e Njeriut dhe të Minoriteteve. 2012. *Strategjia për përmirësimin e pozitës së romëve dhe egjiptianëve në Mal të Zi 2012-2016*. Podgoricë: Ministria për të Drejtat e Njeriut dhe të Minoriteteve.
- Ministria për të Drejtat e Njeriut dhe Refugjatët. 2010. *Plani i rishikuar i veprimët i Bosnjës dhe Hercegovinës për Nevojat e arsimit të romëve*. Sarajevë: Ministria për të Drejtat e Njeriut dhe Refugjatët.
- \_\_\_\_\_. 2013. *Plani i rishikuar i veprimët i Bosnjës dhe Hercegovinës për adresimin e çështjeve rome në fushën e punësimit, banimit dhe kujdesit shëndetësorë 2013-2016*. Sarajevë: Ministria për të Drejtat e Njeriut dhe Refugjatët.
- Ministria e Shëndetit, Politikave Sociale dhe Barazisë. 2010. *Plani i veprimët për zhvillimin e popullatës rome 2010-2012*. Madrid: Ministria e Shëndetit, Politikave Sociale dhe Barazisë.
- Ministria për të Drejtat e Njeriut dhe të Minoriteteve. 2010. *Strategjia për përmirësimin e statusit të romëve në Republikën e Serbisë*. Beograd: Ministria për të Drejtat e Njeriut dhe të Minoriteteve.

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. 2009. *Plani i veprimit për zhvillimin e popullatës romë 2010-2015*. Tiranë: Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

Ministria për Administrim Publik dhe Drejtësi. 2011. *Strategjia Kombëtare për përfshirje sociale: Varfëria e skajshme, varfëria e fëmijëve, romët (2011-2020)*. Budapest: Ministria për Administrim Publik dhe Drejtësi.

Këshilli Kombëtar për bashkëpunim sa i përket çështjeve etnike dhe integritit. 2012. *Strategjia Kombëtare për integrimin e romëve të Republikës së Bullgarisë (2012-2020)*. Sofje: Këshilli Kombëtar për bashkëpunim sa i përket çështjeve etnike dhe integritit.

Zyra për Qeverisje të Mirë. 2014. *Raporti i Katërt i Vlerësimit mbi Zbatimin e Planit të Veprimit dhe Strategjisë së Republikës së Kosovës për Integrimin e Komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptianë, 2013*. Prishtinë: Zyra për Qeverisje të Mirë.

\_\_\_\_\_. 2014. *Raporti i Progresit 2012 mbi Zbatimin e Planit të Veprimit dhe Strategjisë së Republikës së Kosovës për Integrimin e Komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptianë, 2009-2015; Vlerësimi Lokal 2013 dhe Korniza e Prioriteteve 2014-2015*. Prishtinë: Zyra për Qeverisje të Mirë.

\_\_\_\_\_. 2015. *Raporti i Vlerësimit të Kornizës së Prioriteteve për periudhën 2014 mbi Zbatimin e Planit të Veprimit dhe Strategjisë së Republikës së Kosovës për Integrimin e Komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptianë, 2014-2015*. Prishtinë: Zyra për Qeverisje të Mirë.

Asambleja e Përgjithshme e OKB-së. 1948. *Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut*. Paris: Kombet e Bashkuara.

Vijeće Ministara Bosne i Hercegovine. 2005. *Strategjia Bosne i Hercegovine za rješavanje problema Roma [Strategjia e Bosnjës dhe Hercegovinës për zgjidhjen e problemit të romëve]*. Sarajevë: Vijeće Ministara Bosne i Hercegovine.

Vlada Republike Hrvatske. 2012. *Nacionalna strategija za uključivanje Roma, za razdoblje od 2013. do 2020 godine [Strategjia Kombëtare për përfshirjen e romëve, për periudhën prej 2013 deri 2020]*. Zagreb: Vlada Republike Hrvatske.

\_\_\_\_\_. 2013. *Akcijski plan za provedbu Nacionalne strategije za uključivanje Roma, za razdoblje od 2013. do 2015. godine [Plani i veprimit për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për përfshirjen e romëve, për periudhën prej 2013 deri 2015]*. Zagreb: Vlada Republike Hrvatske.